



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. 3138 Prot.

Tiranë, më 05.11.2020

VENDIM

NR. 101, DATË 05.11.2020

PËR  
RINOVIMIN E LICENCËS PËR RITRANSMETIMIN E PROGRAMIT AUDIO ME  
PËRSËRITËS "RADIO BBC"

Në mbështetje të nenit 5 dhe nenit 19, pika 16 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 41/1 dhe 41/2 të rregullores "Për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencës së transmetimit audio", miratuar me vendimin e AMA-s nr. 153, datë 18.07.2016, i ndryshuar si dhe pas shqyrtimit të aplikimit nr. 3444 prot., datë 27.09.2019, të Radio Televizionit Shqiptar, për rinovimin e licencës për subjektin audio me përsëritës "Radio BBC", Autoriteti i Mediave Audiovizive,

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës, për ritransmetimin e programit audio me përsëritës "Radio BBC", për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
2. Reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit nga "Qarqet Tiranë, Durrës, Lezhë dhe Fier", në "Qarqet Tiranë dhe Durrës".
3. Kushtet e licencës së subjektit audio me përsëritës "Radio BBC", mbeten të pandryshuara përveç zonës së ofrimit të shërbimit.
4. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim për pikën 1 i shtrin efektet duke filluar nga data 11.09.2019, ndërsa për pikën 2, hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA